

**Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të  
përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenin 17 të  
Rregullores së Komisionit (EU) 2015/1222 e datës 24  
korrik 2015 mbi themelimin e një udhëzuesi mbi  
alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e konxhestionit**

27 Maj 2016

Të gjithë OST-të, duke marrë parasysh sa vijon:

ku:

1. Ky dokument është një propozim i përbashkët i hartuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit (këtej e tutje referuar si "OST-të") në lidhje me hartimin e një propozimi për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit (këtej e tutje referuar si "MMPRr").
2. Ky propozim (këtej e tutje referuar si "Propozimi MMPRr") merr parasysh parimet e përgjithshme dhe objektivat e përcaktuara në Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1222 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e konxhestionit (më poshtë referuar si "Rregullorja 2015/1222") si dhe Rregulloren (KE) 714/2009 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 mbi kushtet për qasje në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike (më tej referuar si "Rregullorja (KE) Nr. 714/2009"). Synimi i Rregullores 2015/1222 është koordinimi dhe harmonizimi i llogaritjes dhe alokimit të kapacitetit në tregjet ndër-kufitare të ditës në avancë dhe brenda ditës. Për të lehtësuar këto qëllime, është e nevojshme që të gjithë OST-të të përdorin një model të përbashkët të rrjetit. Një model i përbashkët i rrjetit mund të krijohet vetëm në bazë të një metodologjie të përbashkët për ndërtimin e një modeli të tillë.
3. Ndërkohë që MMPRr e përshkruar në Propozimin e tanishëm të MMPRr mundëson krijimin e një modeli të përbashkët të rrjetit, shpërndarjen e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës që kërkohet për të krijuar modelin e rrjetit të përbashkët adresohet në metodologjinë e gjenerimit dhe të ngarkesës së të dhënave të ngarkesës sipas Nenit 16 të Rregullores 2015 / 1222.
4. Neni 17 i Rregullores 2015/1222 përbën bazën ligjore për këtë propozim dhe përcakton disa kërkesa specifike që Propozimi i MMPRr duhet të marrë parasysh:
  1. *Jo më vonë se 10 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të gjithë OST-të bashkërisht do të hartojnë një propozim mbi metodologjinë e modelit të përbashkët të rrjetit. Propozimi do t'i nënshtrohet konsultimeve në përputhje me Nenin 12.*
  2. *Metodologjia e modelit të përbashkët të rrjetit do të mundësojë krijimin e një modeli të përbashkët rrjeti. Ai duhet të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:*
    - a) *përkufizimin të skenarëve, në përputhje me Nenin 18;*
    - b) *përkufizim të modeleve të veçanta të rrjetit në përputhje me Nenin 19*
    - c) *përshkrim të procesit për bashkimin e modeleve individuale të rrjetit për të formuar modelin e përbashkët rrjeti.*
5. Neni 2 (2) i Rregullores 2015/1222 përcakton modelin e rrjetit të përbashkët si:

*"një grup të dhënash në nivel Unioni të dakorduara midis OST-ve të ndryshme dhe që përshkruajnë karakteristikat kryesore të sistemit energjetik (gjenerimin, ngarkesën dhe topologjinë e rrjetit) dhe rregullat për ndryshimin e këtyre karakteristikave gjatë procesit të llogaritjes së kapacitetit"*
6. Neni 2 (4) i Rregullores 2015/1222 përcakton një skenar si:

*"statusi i parashikuar i sistemit energjetik për një kohë të caktuar"*
7. Neni 2 (1) i Rregullores 2015/1222 përcakton një model individual të rrjetit si:

*"një grup të dhënash që përshkruajnë karakteristikat e sistemit energjetik (gjenerimin, ngarkesën dhe topologjinë e rrjetit) dhe rregullat përkatëse për të ndryshuar këto karakteristika gjatë"*

*llogaritjes së kapacitetit, të përgatitura nga OST-të përgjegjëse, për tu bashkuar me komponentët e tjerë të modelit të rrjetit individual me qëllim krijimin e modelit të rrjetit të përbashkët "*

8. Kërkesat e parashtruara në Nenin 17 janë përshkruar më hollësisht në Nenet 18 dhe 19 të Rregullores 2015/1222. Neni 18 mbi skenarët përshkruan:
  1. *"Të gjithë OST-të së bashku do të hartojnë skenarë të përbashkët për secilën periudhë kohore të llogaritjes së kapacitetit të përmendur në Nenin 14 (1) (a) dhe (b). Skenarët e zakonshëm do të përdoren për të përshkruar një situatë specifike parashikuese për gjenerimin, ngarkesën dhe topologjinë e rrjetit për sistemin e transmetimit në modelin e përbashkët të rrjetit.*
  2. *Për çdo periudhë kohore të tregut do të hartohet një skenar për afatet kohore të llogaritjes së kapacitetit të ditës në avancë si dhe brenda ditës.*
  3. *Për secilin skenar, të gjithë OST-të së bashku do të hartojnë rregulla të përbashkëta për përcaktimin e pozicionit neto në secilën zonë ofertuese dhe fluksin për çdo linjë të rrymës së vazhduar. Këto rregulla të përbashkëta do të bazohen në parashikimin më të mirë të pozicionit neto për secilën zonë ofertuese dhe në parashikimin më të mirë të flukseve në çdo linjë të rrymës së vazhduar për çdo skenar dhe do të përfshijë bilancin e përgjithshëm midis ngarkesës dhe gjenerimit për sistemin e transmetimit në Union. Në përputhje me pikën 1.7 të "Aneksit I të Rregullores (KE) Nr. 714/2009", kur përcaktohen skenarët, nuk duhet të ketë diskriminim të panevojshëm ndërmjet shkëmbimeve të brendshme dhe ndërzonale,*

*Paragrafi 1.7 i Aneksit I të Rregullores (KE) Nr. 714/2009 përshkruan si në vijim:*

*"Në përcaktimin e zonave të përshatshme të rrjetit në/dhe ndërmjet të cilave duhet të zbatohet menaxhimi i kongestionit, OST-të duhet të udhëhiqen nga parimet e efektivitetit të kostos dhe minimizimit të ndikimeve negative në tregun e brendshëm të energjisë elektrike. Në mënyrë specifike, OST-të nuk do të kufizojnë kapacitetin e interkoneksionit për të zgjidhur konxhestionet brenda zonës së tyre të kontrollit, përveç arsyeve të lartpërmendura dhe arsyeve të sigurisë operative. Nëse ndodh një situatë e tillë, kjo do të përshkruhet dhe paraqitet në mënyrë transparente nga OST-të për të gjithë përdoruesit e sistemit. Një situatë e tillë do të tolerohet derisa të gjendet një zgjidhje afatgjatë. Metodologjia dhe projektet për arritjen e zgjidhjes afatgjatë duhet të përshkruhen dhe paraqiten në mënyrë transparente nga OST-të për të gjithë përdoruesit e sistemit."*

9. Neni 19 i Rregullores 2015/1222 përcakton kërkesa më specifike në lidhje me modelet e rrjetit individual, blloqet bazë të modelit të rrjetit të përbashkët:
  1. *"Për secilën zonë ofertuese dhe për çdo skenar:*
    - a) *të gjitha OST-të në zonën ofertuese, së bashku do të sigurojnë një model të vetëm të rrjetit individual, i cili është në përputhje me Nenin 18 (3); ose*
    - b) *secili OST në zonën ofertuese do të ofrojë një model individual të rrjetit për zonën e tij të kontrollit, duke përfshirë interkoneksionet, me kusht që shumica e pozicioneve neto në zonat e kontrollit, përfshirë interkoneksionet, që mbulon zonën e ofertimit, është në përputhje me Nenin 18 (3).*
  2. *Secili model individual i rrjetit duhet të paraqesë parashikimin më të mirë të mundshëm të kushteve të sistemit të transmetimit për secilin skenar të specifikuar nga OST-të në kohën kur krijohet modeli i rrjetit individual.*
  3. *Modelet individuale të rrjetit mbulojnë të gjithë elementët e rrjetit të sistemit të transmetimit*

- që përdoren në analizat rajonale të sigurisë operative për periudhën kohore përkatëse.*
4. *Të gjithë OST-të duhet të harmonizojnë në masën maksimale të mundshme mënyrën në të cilën ndërtohen modelet individuale të rrjetit.*
  5. *Çdo OST do të sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme në modelin individual të rrjetit për të lejuar analizën e flukseve të fuqisë aktive dhe reaktive dhe analizat e tensionit në gjendje të qëndrueshme.*
  6. *Kur është e përshtatshme, dhe me marrëveshje midis të gjitha OST-ve brenda një rajoni të llogaritjes së kapacitetit, secili OST në atë rajon të llogaritjes së kapacitetit do të shkëmbejë të dhëna midis njëri-tjetrit për të mundësuar analizë të tensionit dhe qëndrueshmërisë dinamike ".*
10. Neni 27 (1) i Rregullores 2015/1222 formulon një kërkesë që lidhet me procesin e bashkimit:
- "1. Jo më vonë se gjashtë muaj pas vendimit mbi metodologjinë e sigurimit të të dhënave të gjenerimit dhe të ngarkesës të referuara në nenin 16 dhe metodologjisë së modelit të rrjetit të përbashkët të referuar në nenin 17, të gjithë OST-të duhet të organizojnë procesin e bashkimit të modeleve të rrjetit individual".*
11. Paragrafi i parë i nenit 9 (9) të Rregullores 2015/1222 përcakton dy detyrime të mëtejshme:
- "Propozimi për termat dhe kushtet ose metodologjitë duhet të përfshijë një afat kohor të propozuar për zbatimin e tyre dhe një përshkrim të ndikimit të tyre të pritshëm mbi objektivat e kësaj rregulloreje."*
12. Neni 28 (3) deri (5) i Rregullores 2015/1222 formulon detyrime shtesë të rëndësishme për Propozimin e MPRr:
3. *Për secilën kornizë kohore të llogaritjes së kapacitetit, secili OST do të krijojë modelin individual të rrjetit për secilin skenar në përputhje me Nenin 19, me qëllim që të bashkojë modelet individuale të rrjetit në një model të përbashkët të rrjetit.*
  4. *Çdo OST do t'i dorëzojë OST-ve përgjegjëse për bashkimin e modeleve të rrjetit individual në një model të përbashkët të rrjetit, grupin më të besueshëm të vlerësimeve praktike për secilin model të rrjetit individual.*
  5. *Për secilën kornizë kohore të llogaritjes së kapacitetit, do të krijohet një model i vetëm i rrjetit të përbashkët në nivel të Unionit për secilin skenar të përcaktuar në përputhje me nenin 18 duke bashkuar inputet nga të gjitha OST-të që zbatojnë procesin e llogaritjes së kapacitetit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni. "*
13. Neni 9 (9) i Rregullores 2015/1222 kërkon që të përshkruhet impakti i pritshëm i Propozimit të MPRr-së në objektivat e Rregullores 2015/1222. Ndikimi është paraqitur më poshtë (pikat (14) deri në (23) të këtij Seksioni hyrës).
14. Propozimi i MPRr kontribuon dhe në asnjë mënyrë nuk pengon arritjen e objektivave të Nenit 3 të Rregullores 2015/1222. Në veçanti, Propozimi i MPRr shërben si objektiv për nxitjen e konkurrencës efektive në prodhimin, tregtimin dhe furnizimin me energji elektrike (neni 3 (a) i Rregullores 2015/1222) duke kontribuar në llogaritjen e koordinuar të kapacitetit duke përshkruar një metodologji të përbashkët për përgatitjen e modeleve të rrjetit për tu bashkuar në modelin e përbashkët të rrjetit pan-evropian.
15. Në lidhje me sigurimin e përdorimit optimal të infrastrukturës së transmetimit në vijim të nenit 3 (b) të Rregullores 2015/1222, Propozimi i MPRr krijon një metodologji të përbashkët me të cilën vendoset modeli i rrjetit të përbashkët, i cili do të lejojë përcaktime për sa i përket

disponueshmërisë optimale të rrjetit të transmetimit dhe në këtë mënyrë shfrytëzimi optimal i infrastrukturës së transmetimit.

16. Propozimi i MPPRr merr parasysh sigurinë operationale në pajtim me Nenin 3 (c) të Rregullores 2015/1222 duke kërkuar që modelet e rrjetit individual të përmbajnë modelimin specifik të të gjithë elementëve të rrjetit, gjenerimit dhe ngarkesës në 220 kV ose më lart ose më pak se 220 kV ku ato përdoren në analizën rajonale të sigurisë operationale.
17. Në përputhje me Nenin 3 (d) të Rregullores 2015/1222, dhe duke marrë parasysh metodologjitë e llogaritjes së kapacitetit që do të hartohen sipas Rregullores 2015/1222, krijimi i modelit të përbashkët të rrjetit dhe përdorimi i tyre në procesin e llogaritjes së kapacitetit do të optimizojë llogaritjen dhe shpërndarjen e kapacitetit ndër-zonal duke siguruar një metodologji të përbashkët dhe inpute për përgatitjen e modeleve të rrjetit individual që do të shkrihen në modelin e përbashkët të rrjetit pan-evropian.
18. Duke pasur një model të përbashkët të rrjetit të përgatitur mbi bazën e një metodologjie të përbashkët dhe të detyrueshme, Propozimi i MPPRr do të sigurojë që përmbushet objektivi i trajtimit të drejtë dhe jo-diskriminues i OST-ve, NEMO-ve, Agjencisë, autoriteteve rregullatore dhe pjesëmarrësve të tregut, përderisa krijimi i një modeli të përbashkët të rrjetit bazohet në një metodologji të detyrueshme që i është nënshtruar konsultimit të palëve të interesuara në përputhje me Rregulloren 2015/1222 dhe që do të miratohet nga autoritetet rregullatore para aplikimit në Union. Propozimi i MPPRr, në ofrimin e një metodologjie të përbashkët dhe të detyrueshme për ofrimin e modelit të rrjetit të përbashkët dhe duke vënë në dukje përdorimin e modelit të rrjetit të përbashkët në procesin e llogaritjes së kapacitetit, kontribuon gjithashtu në qëllimin e përgjithshëm të qasjes së barabartë në kapacitetin ndër-zonal, sipas nenit 3 (e) të Rregullores 2015/1222.
19. Metodologjia e MPPRr siguron dhe rrit transparencën dhe besueshmërinë e informacionit, në vijim të nenit 3 (f) të Rregullores 2015/1222, duke siguruar monitorimin e treguesve të cilësisë dhe publikimin e treguesve dhe rezultatet e monitorimit si pjesë e të dhënave që do të sigurohen në pajtim me Nenin 31 (3) të Rregullores 2015/1222.
20. Propozimi i MPPRr gjithashtu kontribuon në objektivin e respektimit të nevojës për një treg të drejtë dhe të rregullt dhe formimin e çmimeve (neni 3 (h) i Rregullores 2015/1222) përmes sigurimit të një modeli të përbashkët të rrjetit që do të përdoret në procesin e llogaritjes së kapacitetit në bazë të një metodologjie të përbashkët që specifikon inputet për përgatitjen e modeleve të rrjetit individual që do të bashkohen në modelin e përbashkët pan-Evropian të rrjetit.
21. Propozimi i MPPRr do të kontribuojë në funksionimin efikas afatgjatë dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe të sektorit të energjisë elektrike në Union, duke qenë një model i përbashkët i rrjetit pan-evropian që do të përdoret në mënyrë të koordinuar në të gjithë Unionin.
22. Së fundmi, Propozimi i MPPRr kontribuon në objektivin e sigurimit të qasjes jodiskriminuese ndaj kapacitetit ndër-zonal (neni 3 (j) i Rregullores 2015/1222) përsëri duke ofruar një model të përbashkët të rrjetit, bazuar në një metodologji të përbashkët detyruese, që do të përdoret në procesin e llogaritjes së kapacitetit.
23. Në përfundim, Propozimi i MPPRr kontribuon në objektivat e përgjithshme të Rregullores 2015/1222 në dobi të të gjithë OST-ve, NEMO-ve, Agjencisë, autoriteteve rregullatore dhe pjesëmarrësve të tregut.

Paraqesin këtë propozim mbi MMPRr për të gjitha Autoritet Rregullatore

## **Neni 1. Lënda dhe fushëveprimi**

1. Metodologjia e përbashkët e modelit të rrjetit e përshkruar në këtë propozim është propozimi i përbashkët i të gjitha OST-ve në përputhje me Nenin 17 (të Rregullores 2015/1222).
2. Kjo metodologji do të zbatohet në të gjithë OST-të në zonën e përmendur në Nenin 1 (2) të Rregullores 2015/1222.
3. OST-të jashtë juridiksionit të zonës të përmendur në Nenin 1(2) të Rregullores 2015/1222 mund të krijojnë dhe dërgojnë MIRr të tyre, të lejojnë që ai të bashkohet në MPRr, dhe të bashkohen në procesin MPRr mbi baza vullnetare, me kusht që:
  - a) të jetë teknikisht e mundur dhe në përputhje me kërkesat e Rregullores 2015/1222;
  - b) të bien dakord që do të kenë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi me lidhje me procesin e MPRr-ve si OST-të e përmendur në paragrafin 1; në mënyrë të veçantë, të pranojnë se kjo metodologji dhe metodologjia e sigurimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës sipas Nenit 16 të Rregullores 2015/1222 të zbatohet gjithashtu edhe për palët respektive në zonën e tyre të kontrollit;
  - c) të pranojnë çfarëdo kushtesh të tjera që lidhen me natyrën vullnetare të pjesëmarrjes së tyre në procesin e MPRr që mund të vendosen nga OST-të e përmendur në paragrafin 1;
  - d) OST-të e përmendur në paragrafin (1) kanë lidhur një marrëveshje që rregullon kushtet e pjesëmarrjes vullnetare me OST-të e përmendura në këtë paragraf;
  - e) kur OST-të pjesëmarrës mbi baza vullnetare në procesin e MPRr kanë treguar pajtueshmëri objektive me kërkesat e përcaktuara në (a), (b), (c), dhe (d), OST-të të përmendur në paragrafin 1, pas verifikimit të plotësimin të kriterëve në (a), (b), (c) dhe (d), miratojnë kërkesën e OST-së që dëshiron t'i bashkohet procesit të MPRr në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 9(2) të Rregullores 2015/1222.
4. OST-të e përmendur në paragrafin 1 do të monitorojnë nëse OST-të pjesëmarrëse në procesin e MPRr mbi baza vullnetare në pajtim me paragrafin 3 respektojnë detyrimet e tyre. Nëse një OST merr pjesë në procesin e MPRr në pajtim me paragrafin 3, nuk respekton detyrimet thelbësore në mënyrë që rrezikon dukshëm zbatimin dhe funksionimin e Rregullores 2015/1222, OST-të e përmendur në paragrafin (1) do të ndërpresin pjesëmarrjen vullnetare të OST në procesin e MPRr në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 9(2) të Rregullores 2015/1222.

## **Neni 2. Përkufizimet dhe interpretimi**

Për qëllime të këtij propozimi, termat e përdorur do të kenë kuptimin e përkufizimeve të përfshira në nenin 2 të Rregullores 2015/1222 dhe nenet e tjera të legjislacionit të përmendur aty. Përveç kësaj, do të zbatohen edhe përkufizimet e mëposhtme:

“rrjetet ngjitur” nënkupton zonat që nuk janë pjesë e zonës së kontrollit ose zonës së ofertimit për të cilën është krijuar një MIRr por kufizohen me të;

“masa të dakorduara” do të thotë veprimet korrigjuese të dakorduara për t'u zbatuar bazuar në një model të përbashkët të rrjetit;

"pikë kufitare" nënkupton një element virtual të rrjetit që ndan kufirin ndërmjet dy OST-ve në mënyrë të tillë që kur bëhet modelimi i rrjetit (i) për të gjithë elementet e rrjetit në njërën anë të pikës kufitare përgjegjësia i atribuohet një OST dhe (ii) të gjithë elementet e rrjetit në anën tjetër të pikës kufitare përgjegjësia i atribuohet OST-së tjetër dhe (iii) saktësisht një OST është përgjegjës për modelimin e secilit element të rrjetit përkatës;

"Zona MPRr" do të thotë zona e mbuluar nga modeli i rrjetit të përbashkët; ky është grupi i (i) zonave të ofertimit OST-të e të cilave kontribuojnë me MIRr-në e tyre në MPRr plus (ii) interkoneksionet që lidhin këto zona ofertuese me zonat ofertuese që nuk kontribuojnë me modelin individual të rrjetit në MPRr (d.m.th. nuk janë pjesë e Zonës MPRr);

"Proçesi i MPRr" nënkupton të gjitha fazat dhe të gjitha aspektet e proçesit përmes të cilit OST-të ndërtojnë dhe ndajnë modelet individuale të rrjetit dhe i bashkojnë ato në modelet e përbashkëta të rrjetit;

"model ekuivalent" nënkupton një grup elementesh të modeluar të rrjetit që kanë së bashku të njëjtën sjellje elektrike si një pjesë e rrjetit. Modelet ekuivalente sigurohen përmes një proçesi të njohur si reduktimi i modelit;

"kohëzgjatja maksimale e lejuar e TATL" do të thotë periudha maksimale e kohës që një ngarkesë që tejkalon PATL dhe më të vogël se ose të barabartë me TATL, mund të jetë e qëndrueshme pa rrezik për pajisjet;

"element i rrjetit" do të thotë një aset që është pjesë ose i lidhur me një rrjet transmetimi ose shpërndarjeje, duke përfshirë, por pa u kufizuar në elementet e rrjetit, njësitë gjeneruese dhe ngarkesat;

"supozime operationale" nënkupton të dhëna të ndryshueshme siç janë skedulet dhe parametrat për pjesë të ndryshme të pajisjeve të nevojshme për të përshkruar sjelljen e parashikuar të sistemit të transmetimit;

"kufijtë e monitorimit operacional" do të thotë një nëngrup i kufijve të sigurisë operationale që duhet t'i përmbahet një model i rrjetit;

"PATL (ngarkesa e përhershme e lejuar e transmetimit)" është ngarkesa maksimale në amper, MW ose MVA që mund të mbahet në një linjë transmetimi, kabëll ose transformator për një kohëzgjatje të pakufizuar pa rrezik për pajisjet;

"nyje balancuese" nënkupton një nyje të veçantë virtuale që shërben për të balancuar fuqinë aktive dhe reaktive në studimet e flukseve të ngarkesës;

"TATL (Ngarkesa e Përkohshme e Lejuar e Transmetimit)" do të thotë ngarkimi maksimal në amper, MW ose MVA që mund të mbahet për një kohëzgjatje të kufizuar pa rrezik për pajisjet;

"rryma e çkycjes" do të thotë pragu maksimal i rrymës mbi të cilin një linjë transmetimi, kabëll ose transformator do të çkyçet pa vonesë kohe.

### **Neni 3. Skenarët**

1. Gjatë ndërtimit të modeleve individuale të rrjetit për secilën njësi kohore të tregut dy ditë përpara ditës së shpërndarjes për afatet e llogaritjes së kapacitetit të ditës në avancë, secili OST do të zbatojë parimet e përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 3, si dhe parimet specifike

për afatin e llogaritjes së kapacitetit për ditën në avancë, të përcaktuara në paragrafin 4.

2. Kur ndërtojnë modelet individuale të rrjetit për secilën njësi kohe të tregut për ditën para ditës së shpërndarjes për afatin kohor të llogaritjes së kapacitetit brenda ditës, secili OST do të zbatojë parimet e përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 3 si dhe parimet specifike për afatet e llogaritjes së kapacitetit brenda ditës sipas paragrafit 5.
3. Parimet e mëposhtme janë të zbatueshme për të gjithë skenarët.
  - a) Situata e parashikuar për topologjinë e rrjetit
    - i. ndërprerjet, pavarësisht nga arsyeja e ndërprerjes, do të modelohen pavarësisht nëse elementi i rrjetit pritet të jetë i pa-disponueshëm për të gjithë kohëzgjatjen e skenarit ose vetëm një pjesë të saj;
    - ii. elementet e rrjetit që ndihmojnë në menaxhimin e tensionit do të përfshihen edhe pse ata mund të jenë të çkyçur për arsye operative;
    - iii. topologjia do të pasqyrojë gjendjen operative;
  - b) Ku të dhënat strukturore ndryshojnë gjatë periudhës kohore me të cilën lidhet skenari
    - i. elementët e rrjetit që janë shtuar ose hequr duhet të përfshihen për të gjithë kohëzgjatjen e skenarit dhe duhet të hiqen nga topologjia e MIRr në të gjithë skenarët ku ato nuk janë të disponueshëm për të paktën një pjesë të kohëzgjatjes së skenarit;
    - ii. ndryshimet në karakteristikat e elementeve të rrjetit do të trajtohen duke përfshirë ato karakteristika, përdorimi i të cilave është më tradicional nga pikëpamja e sigurisë operative;
  - c) kufijtë e operimit
    - i. çdo OST do të zbatojë kufijtë e duhur që korrespondojnë me sezonin e synuar për çdo element të rrjetit;
    - ii. për kufijtë termike, çdo OST do të përdorë PATL dhe TATL.
4. Parimet e mëposhtme janë të zbatueshme për të gjithë skenarët e afatit të llogaritjes së kapacitetit për ditën në avancë
  - a) në lidhje me situatën e parashikuar për gjenerimin
    - i. për prodhimin me ndërprerje, secili OST duhet të përdorë parashikimin më të fundit të gjenerimit me ndërprerje;
    - ii. për gjenerimin e dispeçerueshëm secili OST do të marrë parasysh ndërprerjet e planifikuara dhe do të përshtatë gjenerimin e parashikuar, duke marrë në konsideratë parashikimin e prodhimit me ndërprerje, në mënyrë që të balancojë ngarkesën e parashikuar, humbjet në rrjet dhe pozicionin neto;
  - b) në lidhje me situatën e parashikuar për ngarkesën;
    - i. çdo OST do të përdorë parashikimin më të mirë të ngarkesës
  - c) në lidhje me pozicionin neto në secilën zonë ofertuese dhe fluksin për çdo linjë me rrymë të vazhduar.
    - i. secili OST do të ndjekë metodën e përshkruar në Nenin 19.
5. Parimet e mëposhtme janë të zbatueshme për të gjithë skenarët e afatit të llogaritjes së kapacitetit brenda ditës.
  - a) në lidhje me situatën e parashikuar për gjenerimin
    - i. për gjenerimin me ndërprerje, secili OST duhet të përdorë parashikimin më të fundit të gjenerimit me ndërprerje;
    - ii. për gjenerimin e dispeçerueshëm, secili OST duhet të përdorë oraret;



- b) në lidhje me situatën e parashikuar për ngarkesën;
  - i. çdo OST do të përdorë parashikimin më të mirë të ngarkesës
- c) në lidhje me pozicionin neto në secilën zonë ofertuese dhe fluksin për çdo linjë me rrymë të vazhduar.
  - i. secili OST do të përdorë rezultatet e tregut të ditës në avancë sipas Nenit 18.

#### **Neni 4. Modelet individuale të rrjetit**

1. Çdo OST do të ndërtojë modele individuale të rrjetit për secilin nga skenarët e përshkruar në Nenin 3 (1) dhe 3 (2).
2. Gjatë ndërtimit të MIRr, secili OST do të kryejë hapat e mëposhtëm:
  - a) krijojnë një model të përditësuar të pajisjeve që përmban të dhënat strukturore të përshkruara në Nenet 5 deri 11;
  - b) identifikon dhe reflekton ndryshimet strukturore në përputhje me parimet e përcaktuara në Nenin 3;
  - c) përfshin supozimet operative të përditësuara duke përfshirë të dhënat e ndryshueshme të përshkruara në Nenet 12 deri 16;
  - d) shkëmben me të gjithë OST-të e tjerë të dhënat e përshkruara në Nenin 17 nëpërmjet platformës së informacionit të përmendur në Nenin 21;
  - e) zbaton rregullat e përbashkëta për përcaktimin e pozicionit neto në secilën zonë ofertuese dhe fluksin për çdo linjë të rrymës së vazhduar të përcaktuara në Nenet 18 dhe 19;
  - f) siguron që modeli të jetë në përputhje me pozicionet neto dhe flukset në linjat me rryme të vazhduar, të krijuar në përputhje me Nenet 18 dhe 19;
  - g) siguron që veprimet korrigjuese të aplikuar (nëse ka) mund të identifikohen qartë dhe janë në përputhje me metodologjinë për veprimet korrigjuese në llogaritjen e kapacitetit sipas Nenit 25 të Rregullores 2015/1222 dhe objektivin e përgjithshëm të trajtimit të drejtë dhe jo-diskriminues sipas Nenit 3 (e) të Rregullores 2015/1222;
  - h) kryen analizën e flukseve për të verifikuar:
    - i. që zgjidhja plotëson kërkesat;
    - ii. besueshmërinë e niveleve të tensionit në nyjet e rrjetit dhe të flukseve të fuqisë reaktive dhe aktive në elementet e rrjetit;
    - iii. besueshmërinë e prodhimit të fuqisë reaktive dhe aktive të secilit gjenerues;
    - iv. besueshmërinë e prodhimit/konsumit të fuqisë reaktive të shunt-pajisjeve të lidhura në rrjet; dhe
    - v. pajtueshmërinë me standardet e aplikueshme të sigurisë operative
  - i) nëse kërkohet, ndryshon modelin e pajisjeve dhe/ose supozimet operative dhe përsërit hapin (h);
  - j) nëse zbatohet, kryen reduktimin e rrjetit në përputhje me Nenin 11;
  - k) siç kërkohet me Nenin 28(3) të Rregullores 2015/1222 eksporton modelin e MIRr dhe e ve atë në dispozicion të krijimit të modelit të përbashkët të rrjetit në platformën e informacionit të përmendur në Nenin 21;
  - l) sigurohet që MIRr plotëson kriteret e cilësisë në përputhje me Nenin 23;
  - m) përsërit hapat përkatës siç kërkohen dhe në përputhje me detyrimet e tjera të përcaktuara në këtë metodologji.

3. Çdo OST do të respektojë procesin për bashkimin e MIRr në një MPRr të përshkruar në Nenin 20.
4. Secili OST duhet të përditësojë MIRr të tij sipas masave të dakorduara nëse është e zbatueshme.
5. Çdo OST duhet të respektojë kërkesat e parashikuara në Nenin 22. Të gjitha kohët e përcaktuara në këtë Propozim të MMPRr i referohen kohës së tregut, siç përcaktohet në Nenin 2 (15) të Rregullores 2015/1222.

#### **Neni 5. Të dhënat për t'u përfshirë në MIRr-eve**

1. MIRr duhet të përmbajë elementet e rrjetit të tensionit të lartë dhe ekstra të lartë për aq kohë sa ato përdoren në analizën rajonale të sigurisë operationale për periudhën përkatëse kohore.
2. Për çdo element të rrjetit të përfshirë në model do të vendoset një identifikues unik.
3. Ku kjo metodologji i referohet ndarjes sipas burimeve primare të energjisë, është e nevojshme një ndarje në burimet e primare të energjisë në përputhje me ato të përdorura nga platforma e transparencës së informacionit në pajtim me Rregulloren 543/2013.
4. Nëse ndonjë nga të dhënat e kërkuara nuk është e disponueshme për OST, në vend të saj, OST do të përdorë parashikimin e tij më të mirë.

#### **Neni 6. Elementet e rrjetit**

1. Elementet e rrjetit të përshkruar në paragrafin 2 të këtij Neni duhet të përfshihen në çdo MIRr pavarësisht nëse këto janë të operuar nga OST ose OSSh (përfshirë OSMSH) në qoftë se këto elementë të rrjetit janë të nivelit të tensionit:
  - a) 220 kV ose më lart;
  - b) prej më pak se 220 kV dhe elementet e rrjetit të cilët përdoren në analizat e sigurisë operative rajonale.
2. Elementet e rëndësishëm të rrjetit dhe të dhënat që duhet të ofrohen për ta janë:
  - a) Për nën-stacionet: nivelet e tensionit, seksionet e zbarave dhe nëse zbatohet metoda e modelimit e përdorur nga OST për pajisjet komutuese, për të përfshirë identifikuesin e pajisjeve çkyçëse dhe llojin e tyre, thikave, izolatorëve dhe çelësave të ngarkesës;
  - b) Për linjat ose kabllot: karakteristikat elektrike, nën-stacionet në të cilat janë të lidhura;
  - c) Për transformatorët e fuqisë përfshirë transformatorët fazues: karakteristikat elektrike, nën-stacionet ku janë të lidhur, lloji i ancafkave, dhe llojin e rregullimit ku është e mundur;
  - d) Për pajisjet kompensuese të fuqisë dhe sistemet e transmetimit fleksibël AC (FACTS): tipi, karakteristikat elektrike, dhe llojin e rregullimit ku është e mundur.
3. Modeli apo një modeli ekuivalent i atyre pjesëve të rrjetit që operohen në/ose tension më të ulët se 220 kV do të përfshihen në MIRr pavarësisht nëse janë pjesë e rrjetit të OST ose OSSh (përfshirë OSMSH) nëse:
  - a) këto pjesë të rrjetit kanë elementë të përdorur në analizat rajonale të sigurisë operative, ose
  - b) elementet përkatës të rrjetit në këtë pjesë të rrjetit lidhin:
    - i. një njësi gjeneruese ose ngarkese të modeluar në detaje në përputhje me Nenin 8 ose 9 në tension 220 kV apo nivel tensioni më të lartë;

ii. dy nyje në tension 220 kV ose nivel tensioni më të lartë;

4. Modelet dhe modelet ekuivalente sipas paragrafit 3 duhet të përmbajnë së paku agregatorët e ngarkesës të ndarë nga gjenerimi dhe kapacitetin gjenerues sipas burimeve primare të energjisë, dhe të ndarë nga ngarkesa në pjesët përkatëse të rrjetit të ndara sipas nënstacioneve të modelit ekuivalent ose nën - stacioneve në të cilat janë lidhur pjesët përkatëse të rrjetit.

## **Neni 7. Pikat kufitare**

1. Për secilin kufi respektiv, OST-të përkatëse do të ndajnë përgjegjësitë e tyre përkatëse përsa i përket modelimit të rrjetit duke rënë dakord mbi pikat kufitare korresponduese.
2. Secili OST do të përfshijë të gjithë elementët përkatës të rrjetit në anën e tij të secilës pikë kufitare në MIRr të tij.
3. Çdo OST do të përfshijë çdo pikë kufitare në IGM-në e tij me një injektim imagjinar.

## **Neni 8. Gjenerimi**

1. Njësitë gjeneruese përfshirë pompat dhe kompensatorët sinkron duhet të modelohen në detaje, nëse ata janë të lidhur në nivelin e tensionit:
  - a) 220 kV ose më lart;
  - b) më pak se 220 kV dhe që përdoren në analizat rajonale të sigurisë operative.
2. Shumë njësi gjeneruese identike apo të ngjashme mund të modelohen në detaje së bashku nëse ky modelim është i mjaftueshëm në analizat rajonale të sigurisë operative. Për njësitë gjeneruese të modeluara në mënyrë të detajuar së bashku, në MIRr duhet të përfshihet modeli ekuivalent.
3. Kapaciteti gjenerues i modeluar në mënyrë jo të detajuar, në MIRr e modeluar do të përfshihet si shumatore.
4. Si për njësitë gjeneruese të modeluara në mënyrë të detajuar ashtu edhe për ato të modeluara si shumatore të kapacitetit gjenerues, të ndara sipas burimeve primare të energjisë dhe të veçuara nga ngarkesa, në MIRr duhet të përfshihen të dhënat e mëposhtme:
  - a) pika e lidhjes;
  - b) burimi primar i energjisë.
5. Për njësitë gjeneruese të modeluara në mënyrë të detajuar, në MIRr duhet të përfshihen të dhënat e mëposhtme:
  - a) vlerat maksimale dhe minimale të fuqisë aktive; të përcaktuara si vlera për të cilat njësia gjeneruese mund të rregullojë. Në rastin e njësive hidrogjeneruese pump-storage, duhet të modelohen dy cikle dhe duhet të jepen dy të dhënat (d.m.th, nga një për gjenerimin dhe një për mënyrën e pompimit);
  - b) llojin e mënyrës së kontrollit, si më poshtë: "e pa-disponueshme", "në kontroll të tensionit", "në kontroll të faktorit të fuqisë", "në kontroll të fuqisë reaktive" dhe, për njësitë gjeneruese me tension të rregullueshëm, zbarat me tension të rregulluara ku është përcaktuar tensioni i planifikuar;
  - c) vlerat maksimale dhe minimale të fuqisë reaktive kur është shpërndarë vlera minimale dhe maksimale e fuqisë aktive, si dhe kurbën e aftësisë në qoftë se kjo është e nevojshme për analizën rajonale të sigurisë operative;

- d) nevoja vetjake e njësisë gjeneruese që përfaqëson kërkesën e brendëshme të njësisë gjeneruese, nëse është e nevojshme në analizat rajonale të sigurisë operative duhet të modelohet si një ngarkesë jo-konforme në pikën e lidhjes,
6. Për njësitë gjeneruese të modeluara si shumatore në MIRr duhet të përfshihen të dhënat e mëposhtme:
  - a) shumatorja e kapacitetit gjenerues e ndarë sipas burimeve primare të energjisë dhe e ndarë nga ngarkesa në pjesët korresponduese të rrjetit, e klasifikuar sipas nën-stacioneve të modelit ekuivalent apo nën-stacioneve në të cilat janë të lidhura pjesët korresponduese të rrjetit.

## **Neni 9. Ngarkesa**

1. Ngarkesat duhet të jenë të modeluara në detaje nëse janë të lidhura në nivelin e tensionit
  - a) 220 kV ose më lart;
  - b) më pak se 220 kV dhe ato përdoren në analizat rajonale të sigurisë operative.
2. Shumë ngarkesa identike apo të ngjashme mund të modelohen në detaje së bashku nëse ky modelim është i mjaftueshëm për analizat rajonale të sigurisë operative. Për ngarkesat e modeluara në mënyrë të detajuar së bashku, modeli ekuivalent duhet të përfshihet në MIRr .
3. Ngarkesa e modeluar jo në detaje, do të përfshihet në modelin MIRr e modeluar si shumatore.
4. Për ngarkesat e modeluara në mënyrë të detajuar si dhe për ato të modeluara si shumatore të ndara nga gjenerimi, në MIRr duhet të përfshihen të dhënat e mëposhtme:
  - a) pika e lidhjes;
  - b) faktori i fuqisë ose fuqia reaktive
  - c) flamuri i përputhshmërisë (ku vlera "e vërtetë" nënkupton që konsumi i fuqisë aktive dhe reaktive i ngarkesës duhet të jetë i shkallëzuar kur shkallëzohet ngarkesa e përgjithshme).
5. Për ngarkesat e modeluara si shumatore, në MIRr duhet të përfshihen të dhënat e mëposhtme:
  - a) shumatorja e ngarkesës (e ndarë nga gjenerimi) në pjesët korresponduese të rrjetit të ndara sipas nën-stacioneve të modelit ekuivalent apo nën-stacioneve në të cilat janë të lidhura pjesët korresponduese të rrjetit.

## **Neni 10. Lidhjet HVDC**

1. Lidhjet HVDC duhet të modelohen pavarësisht nëse gjenden tërësisht brenda një zonë të vetme ofertuese apo nëse ato lidhin dy zona ofertuese.
2. OST brenda zonës(ave) ofertuese të të cilit ndodhet lidhja HVDC ose OST-të zonat ofertuese të të cilave janë të lidhura nëpërmjet lidhjes HVDC duhet të dakordojnë për detajet për të cilat lidhja HVDC do të modelohet. Ato do të bazojnë vendimin e tyre mbi funksionet për të cilat do të përdoret lidhja HVDC. Në parim, një lidhje HVDC duhet të modelohet në detaje dhe nga OST-te respektive do të shkëmbehet pjesa AC/DC e lidhjes HVDC, përveç nëse funksionet për të cilat ajo përdoret nuk e kërkojnë këtë.
3. Për të dyja lidhjet lidhjet HVDC, si ato të modeluara në mënyrë të detajuar dhe ato të modeluara në mënyrë të thjeshtuar, duhet të përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- a) Pikat e lidhjes.
4. Për lidhjet HVDC ndër-zonale të modeluara në detaje, OST-të respektive do të dakordojnë se në cilat prej tyre do të ofrojë modelin e detajuar, duke e përfshirë atë në MIRr apo duke e bërë atë të disponueshëm veçmas. Në rastin e lidhjeve HVDC që lidhin zonën e MPRr me një zonë ofertimi që nuk është pjesë e zonës së MPRr, OST që është brenda zonës së MPRr do të përfshijë modelin e detajuar në MIRr e tij. Modelet e detajuara të lidhjeve HVDC do të përfshijnë:
  - a) karakteristikat elektrike;
  - b) llojin dhe karakteristikat e mënyrave të komandimit.
5. Lidhjet HVDC të modeluara në mënyrë të thjeshtuar do të përfaqësohen nga injektimet ekuivalente në pikën e lidhjes.
6. Në rastin e lidhjeve HVDC që lidhin zonën e MPRr me një zonë ofertimi që nuk është pjesë e zonës MPRr, OST që është brenda zonës së MPRr do të përpiket të lidhë një marrëveshje me pronarët e lidhjeve HVDC që nuk i nënshtrohen kësaj metodologjie me qëllim sigurimin e bashkëpunimit të tyre në përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në këtë Nen.

## **Neni 11. Modelimi i rrjeteve ngjitur**

1. Çdo OST do të modelojë lidhjet HVDC me rrjetet fqinje në pajtim me Nenin 10.
2. Çdo OST do të modelojë lidhjet AC me rrjetet fqinje siç është përshkruar në këtë Nen.
3. Në fillim të procesit të përshkruar në Nenin 4, çdo OST do të përdorë një model ekuivalent të rrjeteve fqinje në MIRr e tij.

## **Neni 12. Topologjia**

1. Gjatë ndërtimit të MIRr të tij, çdo OST duhet të sigurohet që:
  - a) MIRr tregon gjendjen e çelësave, të hapur ose të mbyllur, të të gjitha pajisjeve komutuese të modeluara;
  - b) MIRr tregon pozicionin e ancafkave në të gjithë transformatorët e fuqisë të modeluar me rregullator tensioni përfshirë transformatorët fazues;
  - c) topologjia e MIRr reflekton padisponueshmërinë e planifikuar ose të detyruar të parametrave të modeluar të pajisjeve që dihet ose që pritet të jenë të padisponueshëm.
  - d) topologjia e MIRr përditësohet për të reflektuar veprimet korrigjuese në përputhje me Nenin 25 të Rregullores 2015/1222 si dhe nëse aplikohen masat e dakorduara mbi topologjinë
  - e) duke marrë parasysh pikat c) dhe d), topologjia e MIRr reflekton gjendjen operacionale më të mirë të mundëshme;
  - f) statusi i lidhjes së interkonektorëve dhe linjave të interkonjeksionit me OST-të e tjera është në përputhje me MIRr e OST-ve fqinje;
  - g) topologjia e të gjitha MIRr të krijuara për qëllime brenda ditës duhet të pasqyrojë padisponueshmërinë e detyruar të pajisjeve të modeluara.

### **Neni 13. Injektimi i energjisë dhe ngarkesat**

1. Gjatë ndërtimit të MIRr të tyre, çdo OST do të respektojë parimet e përgjithshme në lidhje me injektimet e energjisë dhe ngarkesat si më poshtë:
  - a) Për modelin e injektimit të energjisë
    - i. MIRr specifikon një injektim të fuqisë aktive dhe reaktive për çdo njësi gjeneruese të modeluar në shërbim, përfshirë kompensatorër sinkronë dhe pompat, dhe kjo zbatohet për çdo njësi gjeneruese, qoftë e modeluar në detaje mbi një bazë individuale ose të përbërë dhe qoftë të modeluar si një agregat;
    - ii. Injektimi i specifikuar i fuqisë aktive dhe reaktive për çdo njësi gjenerimi të modeluar është në përputhje me limitet e caktuara maksimale dhe minimale të fuqisë aktive dhe reaktive dhe/ose kurbën e aftësisë reaktive;
    - iii. Injektimet e fuqisë aktive të energjisë që lidhen me gjenerimin brenda MIRr duhet të jenë në pajtueshmëri me veprimet korrigjuese përkatëse në përputhje me Nenin 25 të Rregullores 2015/1222 dhe masat e tjera të kërkuara për të ruajtur sistemin brenda kufijve të zbatueshëm operativ të sigurisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në, sigurimin e rezervave të mjaftueshme të fuqisë aktive në rritje dhe në rënie, siç kërkohet për qëllime të menaxhimit të frekuencës;
  - b) Për modelin e ngarkesës
    - i. MIRr specifikon tërheqjen e fuqisë aktive dhe reaktive për çdo ngarkesë dhe pompë të modeluar në shërbim;
    - ii. Tërheqjet e shumës së fuqisë aktive të modeluar, të ngarkesave dhe pompave të modeluara në shërbim duhet të përputhet me ngarkesën totale të skenarit të marrë në konsideratë.
2. Gjatë ndërtimit të MIRr të tyre, çdo OST do të respektojë parimet e përgjithshme të mëposhtme në lidhje me injektimet e energjisë:
  - a) në mënyrë që të krijojë modelin e injektimit për skenarin përkatës, OST do të përshkallëzojë ose përndryshe do të modifikojë individualisht injektimet e fuqisë aktive që lidhen me njësitë gjeneruese të modeluara;
  - b) për njësitë gjeneruese të modeluara në mënyrë të detajuar, gjendja e disponueshmërisë do të marrë parasysh:
    - i. planet e ndërprerjeve;
    - ii. profilet e testimit;
    - iii. padisponueshmërinë e planifikuar;
    - iv. çdo kufizim të kapacitetit të fuqisë aktive;
  - c) për njësitë gjeneruese të dispeçerueshme të modeluara në mënyrë të detajuar, modeli i modeluar i dispeçerimit duhet të marrë parasysh sa më poshtë:
    - i. për të gjithë skenarët
      1. statusin e disponueshmërisë;
      2. politikat dhe marrëveshjet e aplikueshme të dispeçerimit me prioritet;
    - ii. Për afatet kohore për përllogaritjen e kapacitetit të ditës në avancë, parashikimi më i mirë bazohet sipas përzgjedhjes së mëposhtme:
      1. të dhënat përkatëse aktuale, historike ose të parashikuara të të dhënave

- komerciale / tregtare:
    - 2. dallimin midis gjenerimit me bazë ngarkese dhe gjenerimit të marxhinalizuar
    - 3. NKGj(GSK<sup>1</sup>) të përcaktuar, rankimit sipas *merit order* ose faktorëve të pjesmarrëmarrjes.
    - 4. dhe çdo lloj informacioni tjetër të rëndësishëm;
  - iii. për afatin kohor të për llogaritjen e kapacitetit brenda ditës;
    - 1. skedulet më të fundit të disponueshme të tregut
  - d) për njësitë gjeneruese të dispeçerueshme të modeluara si agregator, modeli i dispeçerimit të modeluar do të marrë në konsideratë sa më poshtë;
    - i. për të gjithë skenarët, modelin më të mirë të parashikimit të dispeçerimit të bazuar në përzgjedhjen si më poshtë:
      - 1. të dhënat përkatëse aktuale, historike ose të parashikuara të dhënave komerciale / tregtare:
      - 2. dallimit midis gjenerimit me bazë ngarkese dhe gjenerimin marxhinal;
      - 3. GSK (ndryshimi kryesor i gjenerimit), të përcaktuar, rankimit sipas *merit order* ose faktorëve të pjesmarrëmarrjes.
      - 4. të dhënat mbi kapacitetin gjenerues të njërive gjeneruese të modeluara si agregate, të ndara sipas burimeve primare të energjisë dhe të ndara nga ngarkesa dhe që menaxhohet nga një agregator të dhënat e të cilit përdoren në analizat rajonale të sigurisë operative të ndara sipas nënstacioneve të modelit ekuivalent ose nënstacioneve në të cilat janë lidhur pjesët korresponduese të rrjetit;
      - 5. çdo informacion tjetër të rëndësishëm;
  - e) për të gjithë skenarët, për njësitë gjeneruese me ndërprerje, të modeluara në mënyrë të detajuar, modeli i dispeçerimit të modeluar duhet të marrë parasysh statusin e disponueshmërisë;
  - f) për të gjitha njësitë gjeneruese me ndërprerje, qoftë të modeluara në detaje ose të modeluara si agregate, modeli i dispeçerimit të modeluar duhet marrë në konsideratë:
    - i. për periudhën kohore të llogaritjes së kapacitetit për ditën në avancë, merret parashikimi më i mirë i gjenerimit me ndërprerje që rrjedh nga parashikimet meteorologjike, të përditësuara jo më herët se ora 15:00 në përputhje me Nenin 14 (3) të Rregullores 2015/1222;
    - ii. për periudhën kohore të llogaritjes së kapacitetit brenda ditës, parashikimin më të fundit të gjenerimit me ndërprerje të përfutur nga parashikimet meteorologjike.
3. Gjatë ndërtimit të MIRr të tij, çdo OST do të respektojë parimet e përgjithshme të mëposhtme në lidhje me ngarkesat:
- a) në mënyrë që të përcaktojë modelin e ngarkesës, OST do të përshkallëzojë ose përndryshe do të modifikojë individualisht tërheqjet e fuqisë aktive dhe reaktive në nyje të lidhura me ngarkesat dhe pompat e modeluara;
  - b) për të gjithë skenarët kjo do të bazohet në përzgjedhjen e mëposhtme
    - i. të dhënat përfajqësuese historike referuese, për sezonin përkatës, ditën, kohën përkatëse dhe të dhëna tjera të rëndësishme;

---

<sup>1</sup> Generation Shift Key ose GSK: një grup faktorësh që përshkruajnë vlerësimin linear të ndryshimit më të mundshëm në modelin e gjenerimit në lidhje me ndryshimin e pozicionit neto.



- ii. SCADA dhe/ose të dhënat e matura;
  - iii. të dhënat e vlerësuara të gjendjes;
  - iv. analizat statistikore e të dhënave ose të dhënat e parashikuara;
  - v. dallimin mes ngarkesave që përputhen dhe atyre nuk përputhen;
  - vi. ndërprerjet e planifikuara të paktën për ngarkesat e modeluara në mënyrë të detajuar;
  - vii. për ngarkesat e modeluara në detaje, konsumin maksimal të fuqisë aktive dhe karakteristikat e kontrollit të fuqisë reaktive ku këto janë të instaluar, si dhe fuqinë aktive maksimale dhe minimale të disponueshme për menaxhim e kërkesës dhe kohëzgjatjen maksimale dhe minimale të çdo përdorimi të mundshëm të kësaj fuqie për menaxhim të kërkesës;
  - viii. për ngarkesat e modeluara si agregator dhe të menaxhuara nga një agregator të dhënat e të cilit janë përdorur në analizën rajonale të sigurisë së operimit, shumatorët e fuqisë aktive maksimale dhe minimale në dispozicion për menaxhim të kërkesës, të veçuara nga gjenerimi, dhe kohëzgjatjen maksimale dhe minimale të përdorimit të mundshëm të kësaj fuqie, të disponueshme për menaxhimin e kërkesës së menaxhuar nga agregatori në pjesën përkatëse të rrjetit , të ndarë nga nën-stacionet e modelit ekuivalent ose nën-stacionet në të cilat janë lidhur pjesët përkatëse të rrjetit;
  - ix. çdo informacion tjetër të përshtatshëm;
- c) për afatet e llogaritjes së kapacitetit të ditës në avancë, për ngarkesat e modeluara në detaje që kanë kapacitet për përgjigje të kërkesës, parashikimet e përgjigjes së kërkesës bazohen në
- i. parashikimin e fuqisë aktive të pakufizuar në dispozicion për tu përgjigjur kërkesës dhe çdo përgjigje të planifikuar të kërkesës;
  - ii. NKGj (ndryshimi kryesor i gjenerimit), listimet sipas *merit order* ose faktorëve të pjesmarrëmarrjes;
- d) për periudhën kohore të llogaritjes së kapacitetit brenda ditës, për ngarkesat e modeluara në detaje, MIRr do të pasqyrojë konsumin e skeduar të konsumit të fuqisë aktive dhe parashikimin e konsumit të energjisë reaktive.

## Neni 14. Monitorimi

1. Gjatë ndërtimit të çdo MIRr, çdo OST do të respektojë rregullat e përcaktuara në këtë Nen në lidhje me kufijtë operacional të monitorimit për të gjithë elementet e modeluar të rrjetit.
2. Për çdo skenar të gjithë kufijtë operativ duhet të jenë në përputhje me kushtet operative, duke përfshirë, por jo kufizuar nga stina dhe faktorët mjedisorë dhe meteorologjikë përkatës.
3. Për çdo skenar, çdo OST do të sigurohet që
  - a) MIRr specifikon për çdo linjë transmetimi kabëll, transformator dhe elementët përkatës të pajisjeve DC, të modeluara në mënyrë eksplicite;
    - i. një PATL, nëse vlerësimi nuk varet nga kushtet meteorologjike ose të ngarkesës para-defektit; ose
    - ii. vlerësimin më të mirë të parashikuar nëse vlerësimi varet nga kushtet meteorologjike ose ngarkesa para-defektit;
  - b) MIRr specifikon, për asetet përkatëse, një ose më shumë TATL, pasqyrues për stinën përkatëse dhe bazohet në PATL e zbatuar, për çdo linjë transmetimi, kabëll,



- transformator dhe elementet përkatëse të pajisjes DC të modeluar në mënyrë eksplicite.
- c) MIRr përcakton kohëzgjatjen e një TATL për të gjithë elementët e pajisjeve të transmetimit, për të cilat është specifikuar një TATL, për çdo TATL të specifikuar;
  - d) MIRr specifikon rrymën e çkyçjes për çdo pjesë përkatëse të pajisjeve të transmetimit të modeluar në mënyrë eksplicite, nëse zbatohet;
  - e) MIRr në mënyrë të përshtatshme reflekton vlerat maksimale dhe minimale të pranueshme të tensionit në çdo nivel të tensionit nominal, sipas kodeve lokale respektive, standardeve, liçensave, politikave dhe marrëveshjeve përkatëse;
  - f) kufijtë operativ të monitorimit që zbatohen për interkonektorët dhe tie-line me OST-të e tjerë janë në përputhje me ato të specifikuara në MIRr e OST-ve përkatëse fqinje;
  - g) kufijtë operative të monitorimit të specifikuar në MIRr janë në përputhje me limitet e sigurisë operative;
  - h) MIRr specifikon kufijtë artificialë të PATL dhe TATL mbi elementët individual përkatës ose grupeve të elementëve të pajisjeve të modeluara të transmetimit me qëllim që të përfshijë kufizimet lokale të transmetimit që nuk janë të lidhur me sigurinë termike ose të tensionit të gjendjes së qëndrueshme, duke përfshirë kufizimet që lidhen me gjendjen kalimtare apo qëndrueshmërinë e tensionit;
  - i) MIRr përcakton limitet e duhura operative ekuivalente për të gjitha modelet ekuivalente të pajisjeve të transmetimit dhe elementët e modeluar të pajisjeve që nuk operohen nga OST, duke përfshirë rrjetat e shpërndarjes, që janë të rëndësishme në lidhje me analizën e sigurisë operative dhe llogaritjen e kapacitetit ndër-zonal.

## **Neni 15. Parametrat e kontrollit**

1. Gjatë ndërtimit të çdo MIRr, çdo OST do të përcaktojë parametrat e duhur të kontrollit për të paktën elementet e mëposhtëm të pajisjeve rregulluese, ku janë modeluar dhe përshtatur;
  - a) transformatorët e fuqisë dhe ancafkat e tyre;
  - b) transformatorët fazues dhe ancafkat e tyre;
  - c) pajisjet kompensuese të energjisë reaktive, duke përfshirë por jo kufizuar në:
    - i. shunt- kompensatorët, përfshirë shunt-kapacitorët, shunt-reaktorët ose bankat e shunt-reaktorëve ose kapacitorëve që kyçen në mënyrë specifike
    - ii. kompensatorët statike VAR;
    - iii. kompensatorët sinkron;
    - iv. kompensatorët statike sinkron (STATCOM) dhe pajisje të tjera fleksibël AC të sistemit të transmetimit (FACTS);
  - d) gjeneratorët që marrin pjesë në menaxhimin e tensionit;
  - e) pajisjet DC.
2. Në rastin e elementeve të pajisjeve të përmendura në pikat (a), (b), (c), dhe (d) të paragrafit 1, kur është e nevojshme çdo MIRr duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:
  - a) gjendjen e rregullimit - në punë / jashtë pune;
  - b) mënyrën e rregullimit - tensionin, fuqinë aktive, fuqinë reaktive, faktori i fuqisë, rryma, ose mënyra të tjera të aplikueshme;
  - c) objektivin e rregullimit ose intervali i synuar në kV, MW, Mvar, p.u, ose njësi të tjera të përshtatshme;

- d) deadbandën e synuar të rregullimit;
  - e) faktorin e pjesëmarrjes në rregullim;
  - f) nyjet balancuese.
3. Në rastin e elementëve të përmendur në pikën (e) të paragrafit 1, çdo MIRr duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm, kur është e nevojshme:
- a) regjimin e punës - inverter / shndërrues;
  - b) mënyra e kontrollit – e tensionit, fuqisë aktive, fuqisë reaktive, faktorit të fuqisë, rrymës, ose mënyrat e tjera që zbatohen;
  - c) fuqitë aktive të synuara;
  - d) tensionet e synuara;
  - e) nyjet balancuese.
4. Kur një element i modeluar i pajisjes DC është pjesë e një interkonektori, çdo OST do të sigurohet që flukset rezultante në interkonektor janë në përputhje me flukset e rëna dakord për linjat e rrymës së vazhduar për skenarin përkatës në përputhje me Nenin 18.
5. Çdo OST do të sigurojë që tensionet e synuara dhe diapazonet e synuar të tensionit janë pasqyruese të skenarit përkatës dhe të politikave të zbatueshme në fuqi për menaxhim të tensionit dhe limiteve operative të sigurisë.
6. Çdo OST duhet të specifikojë të paktën një nyje referuese në çdo MIRr për menaxhimin e mospërputhjeve ndërmjet prodhimit dhe kërkesës totale gjatë kryerjes së zgjidhjes me bazë fluksesh.

## **Neni 16. Supozime mbi rrjetet fqinje**

1. Gjatë ndërtimit të MIRr, çdo OST do të përditësojë hipotezat operative në lidhje me rrjetet fqinje me grupin më të besueshëm të vlerësimeve praktike. Pas përfundimit të suksesshëm të kontroleve të përshkruara në Nenin 4 (2) (h), modelet ekuivalente të rrjeteve fqinje do të hiqen dhe zëvendësohen me injektimet ekuivalente në pikat përkatëse kufitare.
2. Për çdo MIRr shuma e injektimeve në pikat kufitare do të jetë e barabartë me pozicionin neto korrespondues.

## **Neni 17. Informacione të tjera respektive**

1. Për të bërë të mundur aplikimin e rregullave për ndryshimin e karakteristikave të modeleve individuale të rrjetit gjatë llogaritjes së kapacitetit dhe proceseve të tjera përkatëse të punës, çdo OST nëpërmjet platformës së informacionit të përmendur në Nenin 21, do të vendosë në dispozicion informacionin e mëposhtëm për të gjithë OST-të:
  - a) NKGj [*GSK ose generation shift keys*].

## **Neni 18. Pozicioni neto dhe flukset në linjat me rrymë të vazhduar**

1. Për të gjithë skenarët, për periudhën kohore të llogaritjes së kapacitetit të ditës në avancë në pajtim të Nenin 3, çdo OST do të ndjekë procedurën e rregullimit të MPRr të përshkruar në Nenin 19 në mënyrë që të jetë pajtueshëm me nenin 18(3) të Rregullores 2015/1222 .
2. Për të gjithë skenarët, për periudhën kohore të llogaritjes së kapacitetit brenda ditës në pajtim me “Nenin 3”, në mënyrë që të jetë pajtueshëm me nenin 18(3) të Rregullores 2015/1222

- a) parashikimi më i mirë i pozicionit neto për secilën zonë ofertuese dhe flukset në çdo linjë të rrymës së vazhduar duhet të bazohet në shkëmbimet e planifikuara të përputhura të vërtetuara;
  - b) çdo OST duhet të ndajë me të gjithë OST-të pozicionin neto për zonën(at) e ofertimit dhe vlerat për flukset në çdo linjë të drejtpërdrejtë aktuale të përdorur në MIRr e tij nëpërmjet platformës së informacionit të përshkruar në Nenin 21 në përputhje me procesin e MPRr të përshkruar në Nenin 22.
3. Për të gjithë skenarët sipas Nenit 3 në rast të zonave ofertuese të lidhura me më shumë se një linjë të rrymës së vazhduar, në mënyrë që të jetë në përputhje me nenin 18 (3) të Rregullores 2015/1222, OST-të në fjalë do të bien dakord mbi vlerat e qëndrueshme të flukseve në linjat e rrymës së vazhduar që do të përdoren në çdo MIRr të OST-së. Këto gjithashtu do të jenë vlerat që OST-të i vënë në dispozicion të të gjithë OST-ve të tjera.

## **Neni 19. Pajtueshmëria e MPRr**

1. Për çdo skenar për llogaritjen e kapacitetit për ditën në avancë në pajtim me Nenin 3, çdo OST do të përgatisë dhe ndajë me të gjitha OST-të tjera nëpërmjet platformës së informacionit të përmendur në Nenin 21, në përputhje me përshkrimin e procesit të MPRr të përcaktuar në Nenin 22 parashikimin e tij më të mirë të:
  - a) pozicionit neto për zonën e tij ofertuese, duke qenë ky pozicioni neto paraprak;
  - b) fluksin për çdo linjë të rrymës së vazhduar në zonën e tij ofertuese duke qenë këto flukset paraprake në çdo linjë të rrymës së vazhduar;
  - c) çdo të dhënë tjetër që kërkohet nga algoritmi në pajtim me paragrafin 2.
2. Të gjithë OST-të bashkërisht do të përcaktojnë një algoritm i cili për secilin skenar dhe për të gjitha zonat ofertuese rregullon pozicionet neto paraprake dhe flukset paraprake në çdo linjë të rrymës së vazhduar në mënyrë të tillë që vijon përshtatjen e bërë nga algoritmi:
  - a) shuma e pozicioneve neto të rregulluara për të gjitha zonat ofertuese në zonën MPRr balancon pozicionin neto të synuar për zonën MPRr;
  - b) për të gjitha zonat ofertuese të lidhura me të paktën një linjë të rrymës së vazhduar, shuma e flukseve në të gjitha linjat e rrymës së vazhduar është reciprokisht në përputhje për të dy zonat ofertuese në fjalë.
3. Algoritmi do të ketë vetitë ose veçoritë si në vijim për të siguruar që në përputhje me Nenin 18 (3) të Rregullores 2015/1222 nuk ka diskriminim të padrejtë ndërmjet shkëmbimeve të brendshme dhe ndër-rajonale:
  - a) rregullimet e pozicioneve paraprake neto dhe flukset paraprake në çdo linjë të rrymës së vazhduar do të përdoren në të gjitha zonat ofertuese dhe asnjë zonë ofertuese nuk do të përfitojë nga trajtimi preferencial apo statusi i privilegjuar në lidhje me operimin e algoritmit;
  - b) Gjatë përcaktimit të përshtatjeve të kërkuara, në funksionin e tij objektiv, algoritmi duhet ti japë rëndësinë e duhur:
    - i. shkallës së rregullimeve të nevojshme për çdo pozicion neto paraprak dhe flukseve paraprake në çdo linjë të rrymës së vazhduar, që duhen minimizuar;
    - ii. aftësisë së një zonë ofertuese për të rregulluar pozicionin neto paraprak dhe flukset paraprake në çdo linjë të rrymës së vazhduar, bazuar në kritere objektive dhe transparente;
  - c) algoritmi duhet të përcaktojë kriteret objektive dhe transparente si dhe kriteret e

- cilësisë së të dhënave që duhet të përmbushë çdo OST;
- d) algoritmi duhet të jetë i aftë mjaftueshëm për të siguruar rezultatet sipas paragrafit 2, në të gjitha rrethanat nëpërmjet të dhënave që i janë ofruar.
4. OST-të do të bien dakord mbi procedurat e:
- a) reduktimit të vlerës absolute të shumës së pozicioneve neto paraprake për të gjitha zonat e ofertimit në zonën MPRr; dhe
  - b) ofrimit të të dhënave të përditësuara nëse është e nevojshme; dhe
  - c) marrjes parasysh të kapacitetit rezervë dhe limitet e qëndrueshmërisë në qoftë së është e nevojshme për përditësimin e të dhënave.
5. OST-të do të rishikojë rregullisht dhe nëse është e nevojshme do të përmirësojnë algoritmin.
6. OST-të do të publikojnë algoritmin si pjesë të të dhënave që do të sigurohen në pajtim me Nenin 31 (3) të Rregullores 2015/1222. Nëse algoritmi është modifikuar gjatë periudhës së raportimit, OST-të duhet të deklarojnë qartë se cili algoritëm ishte në përdorim gjatë asaj periudhe dhe të shpjegojnë arsyet për modifikimin e algoritmit.
7. Të gjithë OST-të së bashku do të sigurohen që algoritmi të jetë i aksesueshëm për palët përkatëse nëpërmjet platformës së informacionit të përmendur në nenin 21.
8. Në përputhje me Nenin 81 të Rregullores 2015/1222, çdo OST do të caktojë një agjent të pajtueshmërisë i cili do të kryejë në emër të OST, detyrat e mëposhtme në përputhje me procesin e përshkruar në Nenin 22:
- a) të kontrollojë plotësinë dhe cilësinë e të dhënave të dhëna sipas paragrafit 1 dhe nëse është e nevojshme, të zëvendësojë të dhënat e munguara ose ato me cilësi të pamjaftueshme me të dhëna zëvendësuese;
  - b) të aplikojë algoritmin në mënyrë që të llogarisë për çdo skenar dhe zonë ofertuese pozicionet neto të rregulluara dhe flukset e rregulluara në të gjitha linjat e rrymës së vazhduar që plotësojnë kriteret e përcaktuara në paragrafin 2 dhe ua vë këto në dispozicion të gjitha OST nëpërmjet platformës së informacionit të përmendur në Nenin 21
  - c) të sigurojë që rezultatet e arritura janë në përputhje me ato të marra nga të gjithë agjentët e pajtueshmërisë (nëse ka).
9. Në bazë të Nenit 4 (2) (f), secili OST do të sigurojë që MIRr i tij është në përputhje me pozicionin neto të rregulluar dhe flukset e rregulluara në linjat me rrymë të vazhduar të siguruar nga agjenti i pajtueshmërisë.

## **Neni 20. Modeli i përbashkët i rrjetit**

1. Në përputhje me Nenin 81 të Rregullores 2015/1222 dhe në pajtim me nenin 27(1) të Rregullores 2015/1222 secili OST do të caktojë një agjent të bashkimit (merging) i cili do të kryejë, në emër të OST, detyrat e mëposhtme sipas procesit të përshkruar në Nenin 22:
  - a) Kontrollon përputhjen e MIRr-ve të ofruara nga OST kundrejt kriterëve të cilësisë të përcaktuara në pajtim me Nenin 23;
  - b) në qoftë së një MIRr nuk ka cilësitë e përmendura në (a), ose krijohet një MIRr i ri më cilësor nga OST përgjegjëse ose zëvendësohet me një MIRr alternativ në përputhje me rregullat e zëvendësimit të përmendura në paragrafin 4 dhe ta bëjë këtë MIRr të vlefshëm të disponueshëm nëpërmjet platformës së informacionit, të përmendur në Nenin 21;
  - c) të zbatojë kërkesat në përputhje me paragrafin 2 në mënyrë që të bashkojë të gjitha MIRr në një MPRr në përputhje me Nenin 28(5) të Rregullores 2015/1222 dhe të bëjë MPRr për të disponueshme për të gjitha OST-të nëpërmjet platformës së informacionit referuar nenit 21 Nenin 21

- d) siguron që çdo MPRr i krijuar është në përputhje me ato të marrë nga gjithë agjentët e bashkimit (nëse ka);
  - e) identifikon cënimet e limiteve të sigurisë operative në MPRr;
  - f) merr nga OST-të MIRr përkatëse të përditësuara sipas masave e dakorduara, nëse aplikohen dhe nëse kërkohet përsërit hapat nga (a) deri (e);
  - g) sipas rastit, vlerëson MPRr përfundimtar dhe e vë atë në dispozicion nëpërmjet platformës së informacionit të përmendur në Nenin 21;
2. Të gjithë OST-të së bashku do të përcaktojnë kërkesat e zbatueshme për agjentet dhe procesin e bashkimit në përputhje me Nenin 24.
  3. Çdo agjent bashkimi duhet të plotësojë kërkesat e përmendura në paragrafin 2 dhe do të zbatojë kërkesat e aplikueshme për procesin e bashkimit të përmendur në paragrafin 2.
  4. Të gjithë OST-të do të përcaktojnë bashkërisht rregullat e zëvendësimit të aplikueshme në MIRr që nuk plotësojnë kriteret e cilësisë të përcaktuara në Nenin 23.
  5. Çdo OST do të sigurojë të dhënat e kërkuara nga rregullat e zëvendësimit të përmendura në paragrafin 4 nëpërmjet platformës së informacionit të përmendur në Nenin 21.

## **Neni 21. Platforma e informacionit**

1. Të gjithë OST-të do të delegojnë detyrën e implementimit dhe administrimit të një platforme të përbashkët informacioni që ofron të paktën shërbimet e përshkruara në paragrafin 2 në përputhje me Nenin 81 të Rregullores 2015/1222.
2. Platforma e Informacionit duhet të mbështesë minimalisht procesin e MPRr në mënyrat e mëposhtme dhe do të ketë të gjitha tiparet e kërkuara për këtë qëllim:
  - a) Periudha kohore e llogaritjes së kapacitetit brenda ditës – çdo OST duhet të mundësojë përdorimin e platformës së informacionit në mënyrë që të ndajë me të gjitha OST-të pozicionin neto për zonën(at) e tij të ofertimit dhe vlerat e flukseve për çdo linjë të rrymës së vazhduar të përdorur në MIRr e tij në pajtim me procesin e MPRr të përshkruar në nenin 22;
  - b) Platforma e Informacionit do të lejojë që të gjithë informacionet mbi shkëmbimet e skeduluara të jenë në dispozicion nga platforma e informacionit;
  - c) periudha kohore e llogaritjes së kapacitetit për ditën në avancë – çdo OST duhet të mundësojë përdorimin e platformës së informacionit në mënyrë që të ndajë me të gjitha OST-të në pajtim me procesin e MPRr të përshkruar në nenin 22 parashikimin më të mirë të tij të;
    - i. pozicionit neto për zonën e tij ofertuese, përfshirë pozicionin neto paraprak;
    - ii. flukset në çdo linjë me rrymë të vazhduar të lidhura në zonën e tij të ofertimit duke përfshirë flukset paraprake në linjat me rrymë të vazhduar;
    - iii. çdo të dhënë tjetër që kërkohet nga algoritmi i përcaktuar në Nenin 19 (2);
  - d) algoritmi, në pajtim me Nenin 19 (2), do të jetë i arritshëm nëpërmjet platformës së informacionit
  - e) agjenti(ë)t e pajtueshmërisë duhet të jenë në gjendje të bëjnë të disponueshme pozicionet neto të rregulluara dhe flukset e rregulluara në linjat e rrymës së vazhduar që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Nenin 19 (2), për të gjithë OST-të nëpërmjet

- platformës së informacionit;
- f) Çdo OST duhet të jetë në gjendje të bëjë të disponueshëm informacionin respektiv të specifikuar në Nenin 17, për të gjitha OST-të nëpërmjet platformës së informacionit;
  - g) çdo OST do të jetë në gjendje të bëjë të gjitha MIRr të disponueshme për të gjitha OST-të nëpërmjet platformës së informacionit;
  - h) për çdo OST dhe çdo skenar, të gjitha të dhënat e kërkuara nga rregullat e zëvendësimit të përmendura në Nenin 20 (5) do të jenë në dispozicion nëpërmjet platformës së informacionit;
  - i) Platforma e Informacionit duhet të jetë në gjendje të ofrojë informacion mbi statusin e cilësisë së MIRr-ve të paraqitura duke përfshirë zëvendësimet që ishin të nevojshme të gjithë agjentët e bashkimit do të jenë në gjendje të bëjnë të disponueshëm MPRr, për të gjithë OST nëpërmjet platformës së informacionit;
  - k) Të gjitha informacionet e kërkuara në lidhje me pikat kufitare sipas Nenit 7 do të jenë të disponueshme nëpërmjet platformës së informacionit;
  - l) Për të gjithë OST, nëpërmjet platformës së informacionit duhet të bëhen të disponueshme pikat e mëposhtme të informacionit dhe/ose të dhënat mbi
    - i. NKGj (GSK generation shift key)

## **Neni 22. Proçesi i MPRr**

1. Gjatë përgatitjes së MPRr për periudhën kohore të llogaritjes së kapacitetit të ditës në avancë, të gjithë OST-të agjentët e bashkimit dhe agjentët e pajtueshmërisë do të plotësojnë hapat e mëposhtëm:
  - a) çdo OST do të vendosë në dispozicion për të gjithë OST-të nëpërmjet platformës së informacionit të referuar në Nenin 21, pozicionet paraprake neto, flukset paraprake në linjat e rrymës së vazhduar, si dhe të gjitha të dhënat e tjera hyrëse të kërkuara për proçesin e rregullimit të MPRr;
  - b) agjentët e pajtueshmërisë do të kontrollojnë plotësinë dhe cilësinë e të dhënave hyrëse të paraqitura në përputhje me Nenin 19 (1) dhe nëse është e nevojshme, të zëvendësojnë të dhënat që mungojnë ose të dhënat me cilësi të pamjaftueshme me të dhëna zëvendësuese;
  - c) agjentët e pajtueshmërisë do të zbatojnë algoritmin për të llogaritur, për secilin skenar dhe çdo zonë ofertuese, pozicionet neto të përafëruara dhe flukset e përafëruara në linjat e rrymës së vazhduar që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Nenin 19 (2);
  - d) agjentët e pajtueshmërisë do të vendosin në dispozicion për të gjithë OST-të nëpërmjet platformës së informacionit të referuar në nenin 21, këto pozicione neto të përafërta dhe flukset e përafëruara në linjat rrymës së vazhduar;
  - e) çdo OST do të vendosë në dispozicion MIRr e tij nëpërmjet platformës së informacionit në përputhje në Nenin 21; në përputhje me Nenin 4 (2) (f), OST do të sigurojë që MIRr i tij të jetë konsistent me pozicionin neto të përafërt dhe flukset e përafëruara në linjat me rrymë të vazhduar të siguruara nga agjentët e pajtueshmërisë;
  - f) agjenti i bashkimit i OST-së:
    - i. do të kontrollojë konsistencën e MIRr të ofruar nga OST kundrejt kritereve të cilësisë të përcaktuara në pajtim me Nenin 23;
    - ii. nëse një MIRr dështon në kontrollin e cilësisë të përmendur në (i), ose



duhet marrë një MIRr i ri me cilësi të mjaftueshme nga OST përgjegjës ose do të zëvendësohet me një MIRr alternativ në përputhje me rregullat e zëvendësimit të referuara në Nenin 20 (5) dhe do ta vendosë në dispozicion këtë MIRr të vlefshëm nëpërmjet platformës së informacionit, të përmendur në Nenin 21;

- g) Agjenti i bashkimit i OST-së:
- i. do të zbatohet kërkesat në përputhje me Nenin 20 (3) me qëllim që të bashkohet të gjitha MIRr-të në një MPRr në pajtim me Nenin 28 (5) të Rregullores 2015/1222 dhe do të vendosë MPRr-të përfundimtare në dispozicion të të gjithë OST-ve dhe llogaritësve të koordinuar të kapacitetit për qëllim të llogaritjes së kapaciteteve, nëpërmjet platformës së informacionit të referuar në Nenin 21;
  - ii. do të vlerësojë çdo MPRr të përfutur dhe sigurojë konsistencën me ato të përfutura nga të gjithë agjentët e bashkimit (nëse ka).
2. Gjatë përgatitjes së MPRr-ve për llogaritjen e kapacitetit brenda ditës, të gjithë OST-të, agjentët e pajtueshmërisë dhe agjentët e bashkimit duhet të plotësojnë hapat e mëposhtëm:
- a) Çdo OST do të vendosë në dispozicion për të gjithë OST-të nëpërmjet platformës së informacionit të referuar në Nenin 21, pozicionin e tij neto dhe flukset në linjat e rrymës së vazhduar për secilin skenar për llogaritjen e kapacitetit brenda ditës. OST-të në zonat ofertuese ku tregu brenda ditës ndër-zonal për ditën pasuese hapet para orës 16:30 do të përdorë të dhënat e orës 16:00
  - b) OST do të vendosë MIRr-në e tij në dispozicion nëpërmjet platformës së informacionit në përputhje me Nenin 21; në përputhje me Nenin 4 (2) (f) OST do të sigurojë që MIRr-ja e tij të jetë konsistente me shkëmbimet e planifikuara të përmendura në Nenin 18 (2), si dhe masat e dakorduara të përcaktuara në bazë të MPRr-së të përgatitura në periudhën kohore paraprake;
  - c) agjenti i bashkimit i OST do të:
    - i. kontrollojë konsistencën e MIRr të ofruar nga OST kundrejt kriterit të cilësisë të përcaktuar në përputhje me nenin 23;
    - ii. nëse një MIRr dështon në kontrollin e cilësisë të përmendur në (i), ose duhet të përftojë një MIRr të ri me cilësi të mjaftueshme nga OST përgjegjëse ose ta zëvendësojë me një MIRr alternativ në përputhje me rregullat e zëvendësimit të përmendura në Nenin 20 (5) dhe të bëjë këtë MIRr të vlerësuar të disponueshëm nëpërmjet platformës së informacionit, të përmendur në Nenin 21;
  - d) agjenti I bashkimit i OST-ve do të
    - i. zbatohet kërkesat e specifikuar në nenin 20 (3) me qëllim që të bashkohet të gjithë MIRr-et në një MPRr në pajtim me nenin 28 (5) të Rregullores 2015/1222 dhe të vejë MPRr-të përfundimtare në dispozicion të të gjitha OST-ve dhe llogaritësve të koordinuar të kapacitetit me qëllim llogaritjen e kapacitetit nëpërmjet platformës së informacionit të përmendur në Nenin 21;
    - ii. vlerëson çdo MIRr të fituar për tu siguruar që është në konsistencë me ata të përfutur nga të gjithë agjentet e shkrirjes të tjerë (nëse ka);
  - e) vazhdimi i vlefshmërisë për MPRr
    - i. agjenti i bashkimit, kur është e zbatueshme, do të bëjnë të disponueshëm një

MPRr të përditësuar duke përfshirë çdo masë të dakorduar.

3. Të gjithë OST-të do të sigurojnë që procesi i bashkimit dhe MPRr të përfundojnë në kohë për afatet kohore të operimit të ditës në avancë dhe brenda ditës të përcaktuara në rregulloren 2015/1222 dhe në përputhje me metodologjitë e kërkuara nga rregullorja 2015/1222, në mënyrë që modeli më i saktë dhe më i fundit i mundshëm të mund të dorëzohet për secilën kornizë kohore të llogaritjes së kapacitetit.

### **Neni 23. Monitorimi i cilësisë**

1. Të gjithë OST-të duhet të përcaktojnë bashkërisht kriteret e cilësisë që MIRr-et duhet të përmbushin në mënyrë që të bashkohen në një model të përbashkët të rrjetit. Një MIRr që nuk i plotëson këto kriteret të cilësisë duhet të zëvendësohet me një MIRr zëvendësues.
2. Të gjithë OST-të duhet të përcaktojnë bashkërisht kriteret e cilësisë që MPRr duhet të plotësojnë para së të mund të bëhen të disponueshëm me anë të platformës së informacionit.
3. Të gjithë OST-të së bashku do të përcaktojnë kriteret që duhet të përmbushin pozicionet paraprake neto dhe flukset paraprake në linjat e rrymës së vazhduar si dhe të dhënat e tjera hyrëse të kërkuara për procesin e rregullimit të MPRr sipas Nenit 19. Grupet e të dhënave që nuk i plotësojnë këto kriteret zëvendësohen me të dhënat zëvendësuese.
4. Të gjithë OST-të do të përcaktojnë së bashku indikatorët e cilësisë që bëjnë të mundur vlerësimin në të gjitha fazat e procesit të MPRr, duke përfshirë në veçanti procesin e rregullimit të MPRr-së të përshkruar në Nenin 19. Ata do të monitorojnë këto tregues të cilësisë dhe do të publikojnë treguesit dhe rezultatet e monitorimit si pjesë e të dhënave që do të ofrohen në pajtim me Nenin 31(3) të Rregullores 2015/1222.

### **Neni 24. Afati kohor i zbatimit**

1. Pas miratimit të kësaj metodologjie çdo OST do ta publikojë atë në internet, në përputhje me Nenin 9 (14) të Rregullores 2015/1222.
2. Të gjithë OST-të së bashku do të hartojnë një kuadër ligjor për platformën e informacionit të përmendur në Nenin 21, i cili minimalisht duhet të adresojë temat e pronësisë, hostimit, shpërndarjes së kostos, kërkesave të licencimit dhe përgjegjësisë së operimit. Ky kuadër ligjor do të përgatitet në një kohë të mjaftueshme sa të lejojë që të gjithë OST-të të përmbushin afatin e përcaktuar në paragrafin 3 dhe do të respektojë dispozitat mbi delegimin e përcaktuar në nenin 81 të Rregullores 2015/1222.
3. Gjashtë muaj pas miratimit të kësaj metodologjie të gjithë OST do të organizojnë procesin e bashkimit të modeleve të rrjeteve individuale duke përmbushur detyrat si më poshtë:
  - a) të gjithë OST-të së bashku do të hartojnë kuadrin ligjor të përmendur në paragrafin 2. Ata duhet të respektojnë dispozitat mbi delegimin të përcaktuara në nenin 81 të Rregullores 2015/1222;
  - b) çdo OST do të formalizojë marrëveshjen e delegimit me agjentin e pajtueshmërisë të përmendur në Nenin 19. Gjatë hartimit të kësaj marrëveshjeje çdo OST do të respektojë dispozitat mbi delegimin, të përcaktuara në nenin 81 të Rregullores 2015/1222.
  - c) të gjithë OST-të së bashku do të specifikojnë dhe zhvillojnë algoritmin e përmendur në Nenin 19. Gjithashtu duhet të specifikojnë rregullat dhe procesin në lidhje me algoritmin e lartpërmendur. Të gjithë OST-të do të publikojnë në internet



- d) specififikimet, rregullat dhe procesin në lidhje me algoritmin e përmendur në Nenin 19; të gjithë OST-të së bashku do të përcaktojnë kriteret e cilësisë dhe treguesit e cilësisë të përmendura në nenin 23;
  - e) të gjitha OST-të së bashku do të formulojnë kërkesat në lidhje me agjentet e bashkimit dhe procesin e bashkimit të përmendur në nenin 20 (2), si dhe rregullat e zëvendësimit të përmendura në nenin 20.(4);
  - f) çdo OST do të formalizojë marrëveshjen e delegimit me agjentët e bashkimit të përmendur në nenin 20. Gjatë hartimit të kësaj marrëveshjeje çdo OST do të respektojë dispozitat mbi delegimin e përcaktuar në nenin 81 të Rregullores 2015/1222.
4. Shtatë muaj pas miratimit të kësaj metodologjie ose me 14 korrik 2017, cilado që të jetë më vonë, platforma e informacionit e përmendur në nenin 21 do të jetë funksionale. Të gjitha OST-të, të gjithë agjentët e pajtueshmërisë dhe të gjithë agjentët e bashkimit do të lidhen me platformën e informacionit dhe do të jenë në gjendje të përdorin të gjitha atributet e tij siç përshkruhet në këtë metodologji.
5. Trembëdhjetë muaj pas miratimit të kësaj metodologjisë ose deri me 14 janar 2018, cilado që të jetë më vonë, të gjithë OST-të së bashku do të sigurojnë që procesi MPRr është funksional dhe i disponueshëm për përdorim nga llogaritësit e kapacitetit të koordinuar.
6. Të gjithë OST-të së bashku do të përgatisin në kohën e duhur të dhënat e disponueshme në lidhje me monitorimin e cilësisë, për t'i lejuar ata të përfshihen në raportin e parë të përmendur në Nenin 31 të Rregullores 2015/1222 që duhet të jetë deri më 14 gusht 2017. Ata do të përgatisin këto të dhëna në vitet e mëvonshme sipas kërkesave.

## **Neni 25. Gjuha**

Gjuha e referencës për këtë propozim CGMM do të jetë anglishtja. Për shmangien e pasigurive, kur OST-të duhet të përkthejnë këtë propozim në gjuhën e tyre kombëtare, në rast të mospërputhjeve midis versionit në gjuhën angleze të botuar nga OST-të në përputhje me Nenin 9 (14) të Rregullores 2015/1222 dhe versionit në një gjuhë tjetër, OST-të përkatëse, në përputhje me legjislacionin kombëtar, do t'u sigurojnë autoriteteve përkatëse kombëtare rregullatore një përkthim të përditësuar të propozimit.